

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, Ndërtesa e “Fakulteteve Teknike”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 38 554 899

URL: <https://fin.uni-pr.edu>

e-mail: fin@uni-pr.edu


Ref. nr. 2515/2

Prishtinë 05/10/2023

Formulari F3

**RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMËS
MASTER**

| FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT | | | |
|--|---|------|------------|
| Vendimi i Këshillit të FIN-it | Nr. 5081/1 | Date | 30.08.2019 |
| Komisioni vlerësues sipas vendimit të këshillit | 1. <i>Prof.asoc.Dr. Misin Misini</i> | | Kryetar |
| | 2. <i>Prof.ass. Dr.Kadri Morina</i> | | Mentor |
| | 3. <i>Prof..asoc. Dr. Cenë Krasniqi</i> | | Anëtar |
| Emri i projekt propozimit i miratuar sipas vendimit të këshillit të FIN. | “Projektimi i konstruksionit te objektit për Depo P+4 me dimensione (35*24)m” | | |
| Vlerësimi i dorëshkrimit: Bazuar në detyren e parashtruar në Raportin e Projektpropozimit dhe punen e realizuar nga kandidati, të pregaditur dhe të prezentuar paraqesim këtë R A P O R T Punimi i diplomës –Master të pregaditur nga Valon Berisha, bsc. ndertim. me titull: “Projektimi i konstruksionit te objektit për Depo P+4 me dimensione (35*24)m” përmban gjithsejt 111 faqe të shkruara dhe aneksin me detale te armimit, 35 figura, 12 tabela, si dhe listet e simboleve dhe shkurtesave te perdorura në punim. Punimi është ndarë në 20 pjese percjellese si ne vijim: 1. Lista e simboleve - Në këtë pjese prezentohen simbolet e perdorura ne punim 2. Abstrakti- perfshin shkurtimisht punimin ne pika te shkurta 3. Arkitektura e objektit – prezentohet baza e objektit dhe prerjet. 4. Projektimi i ndertesave sipas Eurocodet – prezentohet cilat kode perdoren per projektimin e konstruksioneve. | | | |



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, Ndërtesa e “Fakulteteve Teknike”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 38 554 899

URL: <https://fin.uni-pr.edu>

e-mail: fin@uni-pr.edu

Ref. nr. _____

Prishtinë _____ / _____ / _____

5. Analiza e ngarkesave – ne kete pjese behet analizat e ngarkesave te perhersheme, ngarkesat shfrytezuese, ngakesa nga era dhe dbora.

6. Llogaritja e struktures- prezentohet te dhenat per llogaritjen e veprimit sizmik, formimi i modelit matematike, aplikimi i ngarkesave ne model dhe forma e lekundjeve e struktures.

7. Dimensionimi i pllakave- prezentohet dimensionimi i pllakave pa traje duke e ndare ne shirita.

8. Kontrolla nga mosdepertimi- prezentohet si llogaritet mosdepertimi shtylles ne pllake.

9. Kontrollimi i gjendjes kufitare te plasaritjeve- prezentohet se si behet kontrolla e plasaritjeve te pllakatë.

10. Kontrollimi i uljeve-deformimeve- prezentohet kontrolla e uljeve per pllaken ne kohen $t=0$ dhe kohen $t=\infty$.

11. Kontrolli i kapaciteteve te elementeve vertikale- prezentohet kontrolla e betonit per elementet vertikale gjegjesisht kontrolli i duktilitetit lokal per beton.

12. Verifikimet gjeometrike i trareve – ketu eshte prezentue verifikimi i gjeometris se elementeve, efektet projektuese te veprimit, procedurat e projektimit nga momentet e perkuljes dhe transverzaleve, llogaritja e duktilitetin lokal per armature terthore.

13. Dimensionimi i shtylles se perdheses- prezentohet procedura e llogaritjes se shtyllave duke e trajtue nga epja dhe veprimi i momentit dhe forces normale, si dhe llogaritja e duktilitetit lokal te shtyllat.

14. Verifikimi i nyjes shtylle-tra – prezentohet llogaritje e verifikimit te rezistences se nyjes tra shtylle.


15. Verifikimet gjeometrike i mureve dhe nga perkulja- prezentohet gjeometra e mureve dhe llogaritja e duktilitetit lokal te mureve.

16. Dimensionimi i pllakes se themelit- prezentohet llogaritja e themelit pllake duke e trajtue si pllake pa traje dhe llogaritja e mosdepertimit te shtylles ne themel.

17. Perfundimet – prezenton konkluzat ne lidhje me pllakate pa traje dhe themeli pllake.

18. Shpenzimet e materialeve- prezentohet llogaritja e hargjimeve te betonit dhe armatures ndaj sipërfaqes se objektit qe eshte trajtue.

19. Literatura



Ref. nr. _____

Prishtinë ____ / ____ / ____

20. Anexsi- detalet e armimit – ne kete jane prezentue detalet e armimit per te gjitha elementet e konstruksionit.

Punimi i diplomës –Master të kandidatit Valon Berisha bsc.ndërtim. me titull:

“Projektimi i konstruksionit te objektit për Depo P+4 me dimensione (35*24)m”

nga Komisioni vlerësohet se kandidati ka pasur për shtjellim një detyrë që lidhet me Konstruksionet pa traje.

Kandidati ka bërë analizat e modelit te konstruksionit, llogaritjet, dimensionimin e elementeve, detalet e armimit dhe llogaritja e sasise se armatures dhe betonit ne një njësi si dhe në fund jep përfundimet.

Komisioni konsideron se kandidati Valon Berisha, bsc. ndërtim. në këtë punim prezenton njohuri të theksuara në shtjellimin e problematikës te objektet pa traje.

Punimi i dorëzuar për vlerësim i plotëson të gjitha kushtet të cilat kërkohen në Ligjin për Arsimin e Lartë, rregulloren për Studime Master të FN, prandaj me kënaqësi i propozojm Departamentit të Konstruksioneve, Këshillit të fakultetit të Ndërtimtarisë të miratoj këtë Raport dhe të vazhdoi proceduren për mbrojtjen publike publike të tij.

Data e hartimit/nënshkrimit të raportit *04 tetor 2023*

Komisioni Vlerësues:

1. _____
/Prof. asoc. Dr. Misin Misini –kryetar/

2. _____
/ Prof. asis. Dr. Kadri Morina –mentor/

3. _____
/ Prof. asoc. Cenë Krasniqi – anëtar/

P.S. Sipas rregullore nr. 1/334 te datës 31 maj 2023, për studime Master. neni 11, alineja 5. Raporti i Vlerësimit duhet të hartohet në afat prej 15 ditëve, i nënshkruar nga tre anëtarët e komisionit vlerësues, dorëzohet dhe protokollohet tek arkiva e FIN.

ABSTRACT

Planning the construction of a storage facility can be a complex process due to many different factors that must be taken into account. This process involves strategic planning of the space so that it is as practical as possible. Planning is a crucial process because it has a direct impact on the efficiency and productivity of the facility, increasing productivity and reducing costs, ensuring easy access to stored goods. The requirements that come as a result of different types of business should be examined in detail since the changes after the beginning of the construction of the facility have a significant impact on the increase of the overall cost.

The first factor that must be analyzed before starting with the planning and then the construction of a storage facility is the construction location. The easy accesses of the plot which may be needed to accommodate the vehicles that do the unloading and loading of the goods, as well as the space needed to accommodate all the functions should be taken into account before selecting the location. The quality of the soil is also a very important factor that must be taken into account before starting construction. High levels of humidity and the presence of undesirable elements can put stored goods at risk and cause serious physical and financial problems over a long-term period.

Objects or parts of industrial objects that serve as warehouses or storage should be built aiming at a logical connection between the access and circulation of the stored material as well as the circulation of people or vehicles needed depending on the needs. A good connection between transport and storage therefore guarantees efficient operation of the storage space. In the process of designing storage facilities, the type of equipment that will be placed in a certain warehouse plays a key role, thus planning the quantity, weight and frequency of circulation of storage goods, as well as the general organization of the space in connection with the methods of transport. There is a wide range of static and dynamic systems that can be used depending on the different needs of storage, which can function as a separate function or directly related to production. In the second case, special attention should be paid to the paths for the circulation of personnel and tools, as well as to the storage space where specific pallets or crates for product storage should be placed, so that the sorting of products and receiving orders is as easy as possible and efficient. The dimensions of the pallets where the stored goods are stored are standardized at 800 x 1200 x 140 millimeters, but the ways of sorting and placing them can be different.

The large height of the storage space structures is more convenient. In the traditional storage system with flat metal shelves which can hold loads of up to two hundred and fifty kg per shelf, the height is usually preferred to be above 4.5 meters. In spaces that need greater capacity and instead of shelves, modular pallets are used, between which an approach with a minimum width of 2.8 meters is needed, a minimum height of six meters is needed due to the loading and unloading machines. In extreme cases where the goods must be stored in large quantities and densely, the system with total automation thanks to modern machinery must be used, which work by means of special rotating stacking cranes which sometimes require a height of up to twenty five meters.

Objects with a high capacity storage function can also accommodate other auxiliary functions such as: administration, reception space, production space, packaging space, as well as the places needed for parking staff or larger transport vehicles. These buildings are usually constructed of steel frame structures due to the advantage of open and column-free spaces that these types of structures provide.

In conclusion, there are several main relevant factors that should be aimed at when planning storage facilities, and these are

- The structure maximizes the use of space
- To reduce the handling of products to a minimum
- Enable easy access to all or most items
- To optimize the control and quick finding of the inventory
- Elimination of unnecessary activities
- Speeding up tasks related to internal management
- Prevention of congestion at sensitive supply points
- Acceleration of collection and packaging time.

Objects with a storage function can be of the most different shapes and structures, which depend on the demand and the very nature of the work of the respective object, or even the need for adaptation to the terrain and natural factors. It is important that the planned solution, whatever it is, is in accordance with the business requirements, the nature of the work, the nature factor, and the standards of the time.

The main purpose of the design of building structures is to provide sufficient security against potential losses that may occur during the life of the object due to various external influences. These impacts are usually predictable, but random impacts also act on the structure which are fatal for the structure, which we can call as accidental impacts, which include "earthquakes". The impact of an earthquake is impossible to predict when it may occur, so it is determined based on historical observations or by means of probability analysis over a period of time. The purpose of this paper is to present the necessary procedures for the design of reinforced concrete structures according to the Eurocode.

Valon Berisha

ABSTRAKT

Planifikimi i ndërtimit të një objekti me karakter deponues mund të jetë një proces kompleks për shkak të shumë faktorëve të ndryshëm që duhet marrë parasysh. Ky proces përfshin planifikimin strategjik të hapësirës ashtu që ajo të jetë sa më praktike. Planifikimi është proces vendimtarë sepse ka ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin dhe produktivitetin e objektit, rritjen e produktivitetit dhe zvogëlimin e kostove, duke siguruar qasje të lehtë në mallrat e deponuara. Kërkesat të cilat vëjnë si pasojë e llojeve të ndryshme të biznesit duhet të shqyrtohen në mënyrë të detajzuar pasi që ndryshimet pas fillimit të ndërtimit të objektit kanë ndikim të konsiderueshëm në rritjen e kostos së përgjithshme.

Faktori i parë i cili duhet të analizohet para se të fillohet me planifikimin dhe më pastaj ndërtimin e një objekti magazinues është lokacioni i ndërtimit. Qasjet e lehta të parcellës të cilat mund të nevojiten për akomodimin e automjeteve të cilat bëjnë shkarkimin dhe ngarkimin e mallrave, si dhe hapësira e nevojshme për akomodimin e të gjitha funksioneve duhet të meren parasysh para përzgjedhjes së lokacionit. Kualiteti i dheut është poashtu faktorë shumë i rëndësishëm që duhet të merret parasysh para fillimit të ndërtimit. Nivelet e larta të lagështisë dhe prania e elementeve të padëshirueshme mund të vënë mallrat e deponuara në rrezik dhe të shkaktojnë probleme të rënda fizike dhe financiare përgjatë një një periudhe afatgjate.

Objektet apo pjesët e objekteve industriale të cilat shërbejnë në funksion të depove apo magazinimit duhet të ndërtohen duke pasur pikësynim një lidhje të logjishme mes qasjes dhe qarkullimit të materialit të deponuar si dhe qarkullimin e njerëzve apo automjeteve të nevojshme mvarësisht nga nevojat. Një lidhje e mire mes transportit dhe deponimit rrjedhimisht garanton funksionim eficient të hapësirës për deponim. Në procesin e dizajnit të objekteve deponuese, luan rol kyç lloji i pajisjeve të cilat do të vendosen në një depo të caktuar, kështu duke planifikuar sasinë, peshën dhe frekuencën e qarkullimit të mallrave deponuese, si dhe organizimit e përgjithshëm të hapësirës në lidhmëri me metodat e transportit. Egziston një game e gjerë e sistemeve statike dhe dinamike të cilat mund të përdoren varësisht nga nevojat e ndryshme të magazinimit, i cili mund të funksionoj si funksion i veçantë ose i lidhur drejtpërdrejtë me prodhim. Në rastin e dytë duhet kushtuar kujdes të veçantë shtigjeve për qarkullimin e personelit dhe mjeteve, si dhe hapësirës deponuese ku duhet të vendosen paletat apo arkat specifike për magazinimin e produkteve, në mënyrë që renditja e produkteve dhe marrja e porosive të jetë sa më e lehtë dhe efikase. Dimensionet e paletave ku qëndrojnë mallërat e deponuara janë të standardizuara në 800 x 1200 x 140 milimetra por mënyrat e renditjes dhe vendosjes së tyre mund të jenë nga më të ndryshmet.

Lartësia e madhe e strukturave të hapësirave për deponim është gjithnjë më e volitshme. Në sistemin tradicional të magazinimit me raftë të rrafshta metalike të cilat mund të mbajnë ngarkesa deri në dyqind e pesëdhjetë kg për raft lartësia zakonisht preferohet të jetë mbi 4.5 metra. Në hapësirat që nevojitet kapacitet më i madh dhe në vend të rafteve shfrytëzohen paletat modulare, në mes të të cilave nevojitet një qasje me gjërësi minimale prej 2.8 metrash, nevojitet një lartësi minimale prej gjashtë metrash për shkak të makinave ngarkuese dhe zbarkuese. Në rastet ekstreme ku mallrat duhet të deponohen në sasi të madhe dhe të dendur, duhet të përdoret sistemi me automatizim të tërësishëm saje maqinerive modern, që funksionojnë me anë të vinçave të posaçëm rrotullues të grumbullimit të cilave me raste ju nevojitet lartësi deri në njëzet e pesë metra.

Objektet me funksion deponues të kapacitetit të lartë në vete mund të ngërthejnë edhe funksione të tjera ndihmëse si: administratën, hapësirën e pranimit, hapësirën e prodhimit,

hapësirën e paketimit, si dhe vendet e nevojshme për parkimin e stafit apo automjeteve më të mëdha transportuese. Këto objekte janë zakonisht të ndërtuara nga strukturat hapësinore të çelikut për shkak të përparësisë të hapësirave të hapura dhe papenguara nga shtyllat të cilat këto lloje të strukturave mundësojnë.

Si përfundim, ka disa faktorë kryesorë të përgjithshëm të cilëve duhet të synohen të arrihen gjatë planifikimit të objekteve me karakter deponues, e këto janë

- Struktura të maksimizojë shfrytëzimin e hapësirës
- Të reduktohet trajtimi i produkteve në minimum
- Të mundësohet akses i lehtë në të gjithë apo shumicën e artikujve
- Të optimizohet kontrolli dhe gjetja e shpejtë e inventarit
- Eliminimi i aktiviteteve të panevojshme
- Përshpejtimi i detyrave që kanë të bëjnë me menaxhimin e brendshëm
- Parandalimi i bllokimit në pikat e ndjeshme të furnizimit
- Përshpejtimi i kohës së mbledhjes dhe paketimit.

Objektet me funksion të deponimit mund të jenë nga forma dhe struktura prej më të ndryshmeve të cilat mvaren nga kërkesa dhe vetë natyra e punës së objektit përkatës, apo edhe nevojës për përshtatje ndaj terrenit dhe faktorëve natyrorë. Është e rëndësishme që zgjidhja e planifikuar, çfarë do qoftë ajo, të jetë në përputhje me kërkesat e biznesit, natyrën e punës, faktorin natyrë, dhe standardet e kohës.

Qëllimi kryesor i projektimit të strukturave të ndërtimit është që të ofrojë siguri të mjaftueshme ndaj potencialit nga humbjet që mund të jenë gjatë jetës së objektit të cilat ndodhin për shkak të ndikimeve të ndryshme të jashtme. Këto ndikime zakonisht janë të parashikueshme, mirëpo në strukturë veprojnë edhe ndikime të rastit të cilat janë fatale për strukturën, të cilat mund t'i quajmë si ndikime aksidentale, ku në to përfshihen "tërmetet". Ndikimi i tërmetit është e pamundur të parashikohet kur mund të ndodhë, pra, ai është i përcaktuar në bazë të vëzhgimeve historike ose me anë të analizave të probabilitetit në një periudhë kohore. Qëllimi i këtij punimi është që të paraqes procedurat e nevojshme të projektimit të strukturave betonarme sipas Eurokodeve.

Valon Berisha

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDERTIMIT
STUDIMET MASTER, DREJTIMI: KONSTRUKTIV**



PUNIM DIPLOME

- MASTER -

TEMA:

PROJEKTIMI I KONSTRUKSIONIT TË OBJEKTIT PËR DEPO

P+4 ME DIMENSIONE (35*24) m'

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Kadri MORINA

Studenti:

Valon Berisha

Prishtinë, 2023

PËRMBAJTJA

| | |
|--|----|
| 1.LISTA E SIMBOLEVE..... | 4 |
| 2.ABSTRAKT | 10 |
| 3.ARKITEKTURA | 13 |
| 3.1.Pozicionimi I elementeve..... | 13 |
| 3.2.Prerja gjatesore..... | 14 |
| 3.3.Prerja terthore..... | 15 |
| 4. ANALIZA DHE PROJEKTIMI I NDËRTESAVE SIPAS EUROKODEV..... | 16 |
| 4.1 Standartet referuese të përgjithshme..... | 16 |
| 5.ANALIZA E NGARKESAVE | 17 |
| 5.1.Pllaka e kulmit të gjelbërt..... | 17 |
| 5.2.Pllakat e meskateve..... | 18 |
| 5.3.Pllaka e perdheses..... | 19 |
| 5.4 Ngarkesa nga Dëbora..... | 20 |
| 5.5 Ngarkesa nga Era..... | 20 |
| 6.0 LLOGARITJA E STRUKTURËS..... | 29 |
| 6.1Modeli matematikor..... | 31 |
| 6.2 Ngarkesa kryesore-EC-2 (EN 1992-1-1:2004)..... | 32 |
| 6.3 Analiza sizmike..... | 34 |
| 6.4 Format e lëkundjeve | 36 |
| 7.0 DIMENSIONIMI I PLLAKES POS 102-106..... | 38 |
| 7.1 Logaritja e ndikimeve drejtimi gjatesor zona e sipërme..... | 38 |
| 7.2 Logaritja e ndikimeve drejtimi terthor..... | 39 |
| 7.3 Ndikimet-Momentet përkulëse drejtimi x-x të pllakës së katit karakteristik..... | 41 |
| 7.4 Ndikimet-Momentet përkulëse drejtimi y-y të pllakës së katit karakteristik..... | 42 |
| 7.5 Logaritja e ndikimeve drejtimi gjatesor zona e poshtme..... | 45 |
| 8.0 KONTROLLA NGA MOSDEPERTIMI..... | 49 |
| 9.0 KONTROLLIMI I GJENDJES KUFITARE TE PLASARITJEVE..... | 53 |
| 9.1 Llogaritja e gjerësisë së plasaritjeve..... | 53 |
| 10.0 Kontrollimi i elemnetit- pllakes nga fenomeni i uljeve-deformimeve..... | 56 |
| 10.1 Kontrollimi i uljeve të traut për kohën $t=0$ | 56 |
| 10.2 Kontrollimi i uljeve të traut për kohën $t=\infty$ | 58 |
| 11.0 Kontrollimi i kapacitetit të elementeve vertikale,kontrollimi për duktilitet..... | 60 |
| 12.0Verifikimet gjeometrike dhe në përkulje – POS T_1..... | 61 |
| 12.1 Verifikimet e kufizimeve gjeometrike (EN 1998-1, 5.5.1.2.1)..... | 62 |
| 12.2 Efektet projektuese të veprimit..... | 62 |
| 12.3 Procedurat për projektimin e trarëve..... | 65 |
| 12.4 Projektimi i armaturës për përkuljen në trarë..... | 65 |
| 12.5 Përcaktimi i momenteve të projektimit..... | 66 |
| 12.6 Verifikimi nga forcat transversal – POS T_1..... | 70 |
| 12.7 Detajimi për duktilitet lokal – POS T_1..... | 75 |
| 12.8 Inkastrimi dhe vazhdimet Trari POS T_1..... | 77 |
| 13.0 Dimensionimi i shtyllës së përdhësës: PosS1..... | 79 |
| 13.1Përcaktimi i sasisë së armaturës gjatësore të shtyllës..... | 80 |
| 13.2 Përcaktimi i armaturës gjatësore me anën e kurbave plane të bashkëveprimit..... | 80 |
| 13.3 Detajimi për duktilitet lokal (EN 1998-1, 5.5.3.2.2)..... | 87 |
| 13.4 Kërkesa dhe përcaktime normative për duktilitetin e kurbaturës..... | 87 |

| | | |
|------|--|-----|
| 14.0 | Nyja tra-shtyllë , verifikimi i rezistencës..... | 90 |
| 14.1 | Verifikimi i rezistencës relative të trarëve dhe shtyllave | 93 |
| 15.0 | Verifikimet gjeometrike dhe në përkulje – Muri ndaj prerjes POS M-1..... | 94 |
| 15.1 | Dimensionimi i murit M1..... | 95 |
| 15.2 | Llogaritja e armatures nga forca prerëse V_d | 98 |
| 16.0 | Dimensionimi i themel pllakës..... | 100 |
| 16.1 | Verifikimi i soletës në çpim..... | 101 |
| 17.0 | Perfundime..... | 108 |
| 18.0 | Shpenzimi i materialit (betoni dhe armatura)..... | 108 |
| 19.0 | Literatura..... | 109 |
| | ANEX-i -(Pjesa grafike dhe detalet e armimit si bashkangjitje- lidhje e veçantë) | |

1.0 Lista e Simboleve

- A_c sipërfaqja e seksionit e një elementi prej betoni
- A_{Ed} vlera llogaritëse e veprimit sizmik
- A_{Ek} vlera karakteristike e veprimit sizmik për periudhën referencë të rikthimit
- A_{sh} sipërfaqja e përgjithshme e stafave shtrënguese horizontale në një nyjetra-shtyllë
- A_{si} sipërfaqja e përgjithshme e shufrave të çelikut në secilën prej drejtimeve diagonale të një trau lidhës
- A_{st} sipërfaqja e njëres prej degëve të armaturës tërthore
- A_{sv} sipërfaqja e përgjithshme e shufrave vertikale në brinjën e një muri
- $A_{sv,i}$ sipërfaqja e shufrave vertikale, midis shufrave këndore (në qoshe), në njërin drejtim të prerjes tërthore të një shtylle të cilat kalojnë përmes nyjës
- A_w sipërfaqja e përgjithshme e prerjes tërthore horizontale të një muri
- ΣA_{si} shuma e sipërfaqeve të të gjitha shufrave të inklinuara në të dyja drejtimet, në një mur të armuar me shufra të inklinuara, të vendosura për të përballuar rrëshqitjen nga prerja
- ΣA_{sj} shuma e sipërfaqeve të shufrave vertikale në brinjën e një muri, ose e sipërfaqeve të shufrave shtesë, të vendosura në elementët kufizues të murit për të siguruar posaçërisht rezistencën e nevojshme kundrejt prerjes rrëshqitëse
- D_o diametëri i bërthamës së shtrënguar në një kolonë me seksionin rrethor
- E_E efekti i veprimit sizmik
- E_{Edx}, E_{Edy} vlerat projektuese të efekteve sizmike për shkak të komponentëve horizontalë (x dhe y) të veprimit sizmik
- E_d vlera llogaritëse e efekteve të veprimit
- F_i forca sizmike horizontale në katin i .
- F_a forca sizmike horizontale në një element jostrukturorë
- F_b forca prerëse në bazë
- H lartësia e ndërtesës nga themeli ose nga pjesa e sipërme e një bodrumi rigjid
- L_{max}, L_{min} përmasa më e madhe dhe më e vogël në plan e ndërtesës, e matur në drejtime ortogonale

ΣM_{Rb} shuma e vlerave projektuese të momenteve rezistuese të trarëve që lidhen nënjë nyje, sipas drejtimit në shqyrtim

ΣM_{Rc} shuma e vlerave projektuese të momenteve rezistuese të kolonave që lidhen nënjë nyje, sipas drejtimit në shqyrtim

$M_{i,d}$ momenti fundor i një trau ose shtylle për llogaritjen e kapacitetit të tij projektues në prerje

$M_{Rb,i}$ vlera projektuese (llogaritëse) e momentit rezistues të një trau në fundin i

$M_{Rc,i}$ vlera projektuese e momentit rezistues të një kolone në fundin i

N_{Ed} forca aksiale që rezulton nga analiza për situatën sizmike projektuese

N_{SPT} numri i goditjeve nga prova e penetrimit standard

Q veprim i ndryshueshëm

R_d vlera projektuese (llogaritëse) e rezistencës

$S_e(T)$ spektri horizontal i reagimit elastik shprehur në shpejtim (nxitim) të truallit, i emërtuar gjithashtu “spektri i reagimit elastik”. Për $T = 0$, shpejtimi spektral i dhënë nga ky spektër është i barabartë me shpejtimin projektues në truall të tipit A, i shumëzuar me faktorin S të truallit;

$S_{De}(T)$ spektri i reagimit elastik në zhvendosje

$S_d(T)$ spektri i projektimit (për analizën elastike).

S faktori i truallit

T perioda e lëkundjeve e një sistemi linear me një shkallë lirie

T_1 perioda themelore e lëkundjeve të një ndërtese

T_C perioda skajore në kufirin e sipërm të pjesës me shpejtim konstant të spektrit elastik

T_s zgjatshmëria e pjesës së qëndrueshme të lëkundjes sizmike

T_{NCR} periudha referencë e rikthimit e veprimit referencë sizmik, për kërkesën e mosshembjes

V_{Ed} forca prerëse në një mur, që rezulton nga analiza për situatën sizmike projektuese.

V_{dd} rezistenca “në kunj” e shufrave vertikale në një mur

V_{Ed} forca prerëse projektuese në një mur

$V_{Ed,max}$ forca prerëse maksimale vepruese në seksionin fundor të një trau, që rezulton nga llogaritjet e projektimit sipas kapaciteteve

$V_{Ed,min}$ forca prerëse minimale vepruese në seksionin fundor të një trau, që rezulton nga llogaritjet e projektimit sipas kapaciteteve.

V_{fd} kontributi i fërkimit në rezistencën e një muri kundrejt rrëshqitjes nga prerja.
 V_{id} kontributi i shufrave të inklinuara në rezistencën e një muri kundrejt rrëshqitjes nga prerja
 $V_{Rd,c}$ vlera projektuese e rezistencës në prerje për elementë të paarmuar ndaj forcës prerëse, në përputhje me EN 1992-1-1:2004
 $V_{Rd,S}$ vlera projektuese e rezistencës në prerje ndaj rrëshqitjes
 W_a pesha e një elementi jostrukturorë3
 agR shpejtimi maksimal referencë në truall të tipit A
 ag shpejtimi projektues në truall të tipit A
 avg shpejtimi projektues i truallit në drejtimin vertikal
 b gjerësia e flaxhës së poshtme të traut
 bc përmasa e seksionit tërthor të shtyllës
 b_{eff} gjerësia efektive e flaxhës së traut në tërheqje, në faqen e shtyllës mbështetëse
 bi hapi midis dy shufrave të njëpasnjëshme të kapura nga një cep i stafës ose nganjë stafë "S" në një shtyllë
 bo gjerësia e bërthamës së shtrënguar në një shtyllë ose në një element kufitar tënjë muri (referuar vijës qendrore të stafave shtrënguese)
 bw trashësia e pjesëve shtrënguese të një seksioni muri, ose gjerësia e brinjës së njëtrau
 bwo trashësia e brinjës të një muri
 d lartësia efektive e seksionit
 d zhvendosja
 dbL diametri i shufrave gjatësore
 dbw diametri i stafave shtrënguese
 dg zhvendosja projektuese e truallit
 dr drifti projektues i kateve
 ea jashtëqendërsia aksidentale e masës së një kati kundrejt vendndodhjes nominale të saj
 f_{cd} vlera projektuese e rezistencës në shtypje të betonit
 f_{ctm} vlera mesatare e rezistencës në tërheqje të betonit
 f_{yd} vlera projektuese e rezistencës në rrjedhshmëri e çelikut
 $f_{yd,h}$ vlera projektuese e rezistencës në rrjedhshmëri e armaturës horizontale tëbrinjës së murit

- f_{yd,v}* vlera projektuese e rezistencës në rrjedhshmëri e armaturës vertikale të brinjës së murit
- f_{yl}* vlera projektuese e rezistencës në rrjedhshmëri e armaturës gjatësore
- f_{ywd}* vlera projektuese e rezistencës në rrjedhshmëri e armaturës tërthoreg shpejtimi i rënies së lire
- h* lartësia (thellësia) e prerjes tërthore
- h_c* lartësia e seksionit tërthor të shtyllës sipas drejtimit në shqyrtim
- h_f* lartësia e flanxhës
- h_{jc}* largësia midis shtresave skajore të armaturës së shtyllës në një një tra-shtyllë
- h_{jw}* largësia midis armaturës së sipërme dhe të poshtme të traut
- h_o* lartësia e bërthamës së shtrënguar në një kolonë (referuar vijës qendrore të stafave shtrënguese)
- h_s* lartësia neto (dysHEME–tavan) e katit
- h_w* lartësia e murit ose lartësia e prerjes tërthore të traut
- k_D* faktori që pasqyron klasën e duktilitetit në llogaritjen e lartësisë së kërkuar të shtyllës për ankorimin e shufrave të traut në një nyje; merret i barabartë me 1 për DCH dhe me 2/3 për DCM
- k_w* faktori që pasqyron mënyrën mbizotëruese të shkatërrimit në sistemet strukturore me mure
- l_{cl}* gjatësia e neto e një trau ose një shtylle
- l_{cr}* gjatësia e rajonit kritik
- l_i* largësia midis vijave qendrore (akseve) të dy grupe shufrash të inklinuara në seksionin e bazës së mureve që kanë shufra të inklinuara kundrejt rrëshqitjes nga prerja
- l_w* gjatësia e prerjes tërthore të murit
- m_i* masa e katit *i*
- n* numri i kateve sipër themelit ose mbi nivelin e sipërm të një bodrumi rigjid
- n* numri i përgjithshëm i shufrave gjatësore të kapura nga stafa shtrënguese ose stafa “S” sipas perimetrit të seksionit të shtyllës
- q* faktori i sjelljes
- q₀* vlera bazë e faktorit të sjelljes
- q_d* faktori i sjelljes për zhvendosjen
- s* hapi midis shufrave të armimit tërthor

- s_i zhvendosja e masës m_i sipas formës së tonit (modës) themelor të një ndërtese
 x_u lartësia e aksit neutral
 z krahu i forcave të brendshme (krahu i forcës, i çiftit të forcave)
 z_i lartësia e masës m_i sipër nivelit të aplikimit të veprimit sizmik
 α raporti i shpejtimit projektues të truallit kundrejt shpejtimit të gravitetit
 α_0 raporti mbizotërues i “aspektit” (raporti lartësi:gjerësi) në muret e sistemeve strukturore
 α_1 shumëzuesi i veprimit projektues sizmik horizontal, për çastin e formimit të çernierës së parë plastike në sistemin strukturor
 α_u shumëzuesi i veprimit projektues sizmik horizontal, për çastin e formimit të mekanizmit plastik global
 ϵ_{cu2} deformacioni i fundit për betonin e pashtrënguar
 $\epsilon_{cu2,c}$ deformacioni i fundit për betonin e shtrënguar
 $\epsilon_{su,k}$ vlera karakteristike e zgjatimit të fundit të armaturës së çelikut
 $\epsilon_{sy,d}$ vlera projektuese e deformacionit të çelikut në rrjedhshmëri
 v forca aksiale e normalizuar kundrejt madhësisë $A_c \cdot f_{cd}$, e cila i korrespondon situates sizmike projektuese
 $v_{s,30}$ vlera mesatare e shpejtësisë së përhapjes së valëve S , në 30 m e sipërm tëprofilit të dheut, me deformacion në prerje të barabartë me 10-5 ose më pak
 γ_c faktori pjesor për betonin
 γ_d faktori i mbirezistencës për diafragmat
 γ_{Rd} faktori që pasqyron pasigurinë e vlerës projektuese të rezistencave gjatë vlerësimit të efekteve të veprimit në projektimin sipas kapaciteteve, duke marrëparasysh burimet e ndryshme të mbirezistencës
 γ_s faktori pjesor për çelikon
 γ_I faktori i rëndësisë
 η faktori i korigjimit të shuarjes
 η faktori reduktues i rezistencës në shtypje të betonit, për shkak të deformacioneve tërheqëse në drejtimin tërthor
 ζ raporti $V_{Ed,min}/V_{Ed,max}$, midis forcave prerëse vepruese minimale dhe maksimale në seksionet fundore të një trau
 ξ raporti i shuarjes viskoze (në përqindje)
 ξ lartësia e normalizuar e aksit neutral

| | |
|---------------|---|
| μ_f | koeficienti i fërkimit beton-beton në kushtet e veprimeve ciklike |
| μ_Φ | faktori i duktilitetit në kurbaturë |
| μ_δ | faktori i duktilitetit në zhvendosje |
| ρ | raporti i armaturës së tërhequr |
| ρ' | raporti i armaturës së shtypur në trarë |
| ρ_h | raporti i armaturës së shufrave horizontale të brinjës në një muri |
| ρ_l | raporti i përgjithshëm i armaturës gjatësore |
| ρ_{max} | raporti maksimal i lejuar i armaturës së tërhequr në rajonin kritik të trarëve parësorë sizmikë |
| ρ_v | raporti i armaturës së shufrave vertikale të brinjës në një muri |
| ρ_w | raporti i armaturës për prerjen |
| σ_{cm} | vlera mesatare e sforcimit normal në beton |
| ω_v | raporti mekanik i armaturës vertikale të brinjës |
| ω_{wd} | raporti vëllimor mekanik i armaturës shtrënguese |
| θ | koeficienti i ndjeshmërisë (“sensitivity”) i drifteve i kateve |
| $\psi_{2,i}$ | koeficienti i kombinimit për vlerën thuajse-të përhershme të veprimit të ndryshueshëm i |
| $\psi_{E,i}$ | koeficienti i kombinimit për një veprim të ndryshueshëm i , që duhet marrë parasysh kur përcaktohen efektet e veprimit sizmik projektues. |

2.0 ABSTRAKT

Planifikimi i ndërtimit të një objekti me karakter deponues mund të jetë një proces kompleks për shkak të shumë faktorëve të ndryshëm që duhet marrë parasysh. Ky proces përfshin planifikimin strategjik të hapësirës ashtu që ajo të jetë sa më praktike. Planifikimi është proces vendimtarë sepse ka ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin dhe produktivitetin e objektit, rritjen e produktivitetit dhe zvogëlimin e kostove, duke siguruar qasje të lehtë në mallrat e deponuara. Kërkesat të cilat vëjnë si pasojë e llojeve të ndryshme të biznesit duhet të shqyrtohen në mënyrë të detajzuar pasi që ndryshimet pas fillimit të ndërtimit të objektit kanë ndikim të konsiderueshëm në rritjen e kostos së përgjithshme.

Faktori i parë i cili duhet të analizohet para se të fillohet me planifikimin dhe më pastaj ndërtimin e një objekti magazinues është lokacioni i ndërtimit. Qasjet e lehta të parcellës të cilat mund të nevojiten për akomodimin e automjeteve të cilat bëjnë shkarkimin dhe ngarkimin e mallrave, si dhe hapësira e nevojshme për akomodimin e të gjitha funksioneve duhet të meren parasysh para përzgjedhjes së lokacionit. Kualiteti i dheut është poashtu faktorë shumë i rëndësishëm që duhet të merret parasyshë para fillimit të ndërtimit. Nivelet e larta të lagështisë dhe prania e elementeve të padëshirueshme mund ti vënë mallrat e deponuara në rrezik dhe të shkaktojnë probleme të rënda fizike dhe financiare përgjatë një një periudhe afatgjate.

Objektet apo pjesët e objekteve industriale të cilat shërbejnë në funksion të depove apo magazinimit duhet të ndërtohen duke pasur pikësynim një lidhje të logjikshme mes qasjes dhe qarkullimit të materialit të deponuar si dhe qarkullimin e njerëzve apo automjeteve të nevojshme mvarësisht nga nevojat. Një lidhje e mire mes transportit dhe deponimit rrjedhimisht garanton funksionim eficient të hapësirës për deponim. Në procesin e dizajnit të objekteve deponuese, luan rrol kyç lloji i pajisjeve të cilat do të vendosen në një depo të caktuar, kështu duke planifikuar sasinë, peshën dhe frekuencën e qarkullimit të mallrave deponuese, si dhe organizimit e përgjithshëm të hapësirës në lidhmëri me metodat e transportit. Egziston një game e gjerë e sistemeve statike dhe dinamike të cilat mund të përdoren varësisht nga nevojat e ndryshme të magazinimit, i cili mund të funksionoj si funksion i veçantë ose i lidhur drejtpërdrejtë me prodhim. Në rastin e dytë duhet kushtuar kujdes të veçantë shtigjeve për qarkullimin e personelit dhe mjeteve, si dhe hapësirës deponuese ku duhet të vendosen paletat apo arkat specifike për magazinimin e produkteve, në mënyrë që renditja e produkteve dhe marrja e porosive të jetë sa më e lehtë dhe efikase. Dimensionet e paletave ku qëndrojnë mallërat e deponuara janë të standardizuara në 800 x 1200 x 140 milimetra por mënyrat e renditjes dhe vendosjes së tyre mund të jenë nga më të ndryshmet.

Lartësia e madhe e strukturave të hapësirave për deponim është gjithnjë më e volitshme. Në sistemin tradicional të magazinimit me raftet e rrafshta metalike të cilat mund të mbajnë ngarkesa deri në dyqind e pesëdhjetë kg për raft lartësia zakonisht preferohet të jetë mbi 4.5 metra. Në hapësirat që nevojitet kapacitet më i madh dhe në vend të rafteve shfrytëzohen paletat modulare, në mes të të cilave nevojitet një qasje me gjërësi minimale prej 2.8 metrash, nevojitet një lartësi minimale prej gjashtë metrash për shkak të makinave ngarkuese dhe zbarkuese. Në rastet ekstreme ku mallrat duhet të deponohen në sasi të madhe dhe të dendur, duhet të përdoret sistemi me automatizim të tërësishëm saje maqinerive modern, që funksionojnë me anë të vinçave

të posaçëm rrotullues të grumbullimit të cilave me raste ju nevojitet lartësi deri në njëzet e pesë metra.

Objektet me funksion deponues të kapacitetit të lartë në vete mund të ngërthejnë edhe funksione të tjera ndihmëse si: administratën, hapësirën e pranimit, hapësirën e prodhimit, hapësirën e paketimit, si dhe vendet e nevojshme për parkimin e stafit apo automjeteve më të mëdha transportuese. Këto objekte janë zakonisht të ndërtuara nga strukturat hapësinore të çelikut për shkak të përparësisë të hapësirave të hapura dhe papenguara nga shtyllat të cilat këto lloje të strukturave mundësojnë.

Si përfundim, ka disa faktorë kryesorë të përgjithshëm të cilëve duhet të synohen të arrihen gjatë planifikimit të objekteve me karakter deponues, e këto janë

- Struktura të maksimizojë shfrytëzimin e hapësirës
- Të reduktohet trajtimi i produkteve në minimum
- Të mundësohet akses i lehtë në të gjithë apo shumicën e artikujve
- Të optimizohet kontrolli dhe gjetja e shpejtë e inventarit
- Eliminimi i aktiviteteve të panevojshme
- Përshpejtimi i detyrave që kanë të bëjnë me menaxhimin e brendshëm
- Parandalimi i bllokimit në pikat e ndjeshme të furnizimit
- Përshpejtimi i kohës së mbledhjes dhe paketimit.

Objektet me funksion të deponimit mund të jenë nga forma dhe struktura prej më të ndryshmeve të cilat mvaren nga kërkesa dhe vetë natyra e punës së objektit përkatës, apo edhe nevojës për përshtatje ndaj terrenit dhe faktorëve natyrorë. Është e rëndësishme që zgjidhja e planifikuar, çfarë do qoftë ajo, të jetë në përputhje me kërkesat e biznesit, natyrën e punës, faktorin natyror, dhe standardet e kohës.

Qëllimi kryesor i projektimit të strukturave të ndërtimit është që të ofrojë siguri të mjaftueshme ndaj potencialit nga humbjet që mund të jenë gjatë jetës së objektit të cilat ndodhin për shkak të ndikimeve të ndryshme të jashtme. Këto ndikime zakonisht janë të parashikueshme, mirëpo në strukturë veprojnë edhe ndikime të rastit të cilat janë fatale për strukturën, të cilat mund t'i quajmë si ndikime aksidentale, ku në to përfshihen “tërmetet“. Ndikimi i tërmetit është e pamundur të parashikohet kur mund të ndodhë, pra, ai është i përcaktuar në bazë të vëzhgimeve historike ose me anë të analizave të probabilitetit në një periudhë kohore. Qëllimi i këtij punimi është që të paraqes procedurat e nevojshme të projektimit të strukturave betonarme sipas Eurokodeve.

Paketa e Eurokodeve e nevojshme për projektimin e strukturave betonarme është dhënë në pikën 1 të këtij punimi, po ashtu në pikën 2 dhe 3 është bërë përshkrimi në pika të shkurtra rreth qëllimit të Eurokodit 8 – pjesa 1 dhe

Eurokodit 0 , ku është treguar mundësia e lidhjes së EC8 me Eurodokat tjera. Pikat në vazhdim 4 deri 6 paraqesin dispozita dhe rregulla të përgjithshme të Eurokodit8 – pjesa 1, për tipe të ndryshme të ndërtesave.

Pika 7 - trajton rregulla të veçanta (specifike) për ndërtesat prej betoni të armuar, ndërsa pika 8 trajton dispozita nga EN206-1, të cilat kanë të bëjnë me rregulla rreth betonit të njomë me përbërësit e tij dhe betonit të ngurtësuar.

Pika 9 gjashtë është paraqitur trajtimi i një depo nga betoni i armuar me duktilitet të mesëm (DCM), e cila përbëhet nga perdhesa dhe 4 kate.Ndërtesa është zgjedhur sistem dual (ekuivalent me ramë ose me mure) si karakteristik kemi pllake te rrafshet.Për shqyrtim është përzgjedhur një ram karakteristik ku në të janë përzgjedhur pllaka e rrafshet qe mbeshtetet ne shtylla trajet perimetrike dhe shtyllat të cilat i takojnë një nyje karakteristike.

Për llogaritjen dhe detajet e armimit për këto elementeve strukturore janë përdorur parimet e “Projektimit sipas Kapaciteteve“, e gjitha duke ndjekur kërkesat e Eurokodit 8 dhe Eurokodit 2 për shqyrtimet e kërkuara.

3. ARKITEKTURA

3.1 POZICIONIMI I ELEMENTEVE




Fig.1 Baza e katit karakteristik

Prerja gjatesore I-I




Fig.2 Prerja ne drejtimin x-x

Prerja terthore I-I




Fig.3 Prerja ne drejtimin y-y

4.0 ANALIZA DHE PROJEKTIMI I NDËRTESAVE SIPAS EUROKODEVE

4.1 Standartet referuese të përgjithshme

EN 1990 Eurokodi 0: Bazat e projektimit strukturor

EN 1991 Eurokodi 1: Veprimet mbi strukturat

EN 1992 Eurokodi 2: Projektimi i strukturave prej betoni

EN 1993 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku

EN 1994 Eurokodi 4: Projektimi i strukturave kompozite prej çeliku dhe betoni

EN 1995 Eurokodi 5: Projektimi i strukturave prej druri

EN 1996 Eurokodi 6: Projektimi i strukturave me muraturë

EN 1997 Eurokodi 7: Projektimi gjeoteknik

EN 1998 Eurokodi 8: Projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmetit

5. Analiza e ngarkesave

5.1. Pllaka e kulmit të gjelbërt-pozicioni

a) Ngarkesa e vetjake (përhershme) G1 :

Është përfshirë përmes modelit numerik-programit (softver-it)

b) Ngarkesa e përhershme: G2

c) Ngarkesa shfrytëzuese (përkohshme) $q=2.0 \text{ kN/m}^2$




Fig.4.0. Prerja e pllakës-kulmit të gjelbërt

Tabela 1.0 Ngarkesat karakteristike të shtresave në meskate:

| | d (m) | γ (kN/m ³) | $d \times \gamma$ |
|--|---------|-------------------------------|-------------------|
| Toka-dheu për gjelbrim | 0.10 | 17 | 1.70 |
| Gjeotekstil thrace | | | 0.015 |
| Shtresa e zhavorit | 0.07 | 19 | 1.33 |
| PVC folje ,izolimi termik dhe folje difuzive | 0.15 | 2.2 | 0.33 |
| Shtresa betonarme | 0.06 | 25 | 1.50 |
| Barrier avujsh dhe hidroizolimi | 0.01 | 18 | 0.18 |
| Suvatim | 0.01 | 20 | 0.2 |

Ngarkesa e përhershme: G2 : $\Delta g = 5.25 \text{ kN/m}^2$

5.2 .Pllakat e meskateve

a) Ngarkesa e vetjake (perhershme) G1:

Është përfshirë përmes modelit numerik-programit (softver-it)

b) Ngarkesa e përhershme: G2 :

c) Ngarkesa shfrytëzuese (përkohshme) $q=6.0 \text{ kN/m}^2$




Fig.5.0. Prerja e pllakës-konstr.meskator

Tabela 2.0 Ngarkesat karakteristike të shtresave në meskate:

| | d (m) | γ (kN/m ³) | $d \times \gamma$ |
|---------------------------------------|---------|-------------------------------|-------------------|
| Epoxide | 0.01 | 12 | 0.12 |
| Shtresa rrafshuese | 0.05 | 19 | 0.95 |
| Izolimi termik XPS 40 mm dhe Folje | 0.05 | 0.5 | 0.025 |
| Suvatimi | 0.01 | 20 | 0.2 |

Ngarkesa e përhershme: G2 : $\Delta g = 1.3 \text{ kN/m}^2$

5.3 Pllaka e perdheses (themelit)

a) Ngarkesa e vetjake (perhershme) G1:

Është përfshirë përmes modelit numerik-programit (softver-it)

b) Ngarkesa e përhershme: G2

c) Ngarkesa shfrytëzuese (përkohshme) $q=10.0 \text{ kN/m}^2$




Fig.6.0. Prerja e pllakës-ne perdhese

Tabela 3-0 Ngarkesat karakteristike të shtresave në pllaken e themelit:

| | d (m) | γ (kN/m ³) | $d \times \gamma$ |
|---------|---------|-------------------------------|-------------------|
| Epoxide | 0.01 | 12 | 0.12 |

Ngarkesa e përhershme:G2 : $\Delta g =0.12 \text{ kN/m}$

5.4 Ngarkesa nga Dëbora

Sipas prEN 1991-1-3 ngarkesa e dëborës në çati caktohet sipas ekuacionit:

$$s = \mu_i \cdot C_e \cdot C_t \cdot S_k \quad (1)$$

ku: μ_i - koeficienti i formës së kulmit

C_e – koeficienti i ekspozimit (zakonisht $C_e = 1.0$)

C_t – koeficienti termik (zakonisht $C_t = 1.0$)

S_k - vlera karakteristike e ngarkesës së borës në tokë për lartësinë përkatëse

Përcaktimi i ngarkesës së dëborës në tokë

Ekuacioni për rajonin e përvetsuar klimatik Central EAST-zona 1

$$S_k = (0.264 \cdot Z - 0.002) * [1 + \left(\frac{A}{256}\right)^2] \quad \text{kN/m}^2$$

ku: Z - numri i zonës (në varësi të ngarkesës së dëborës në nivelin e detit)

A - lartësia mbi nivelin e detit ($A=550$ m)

$$S_k = (0.264 \cdot 1 - 0.002) * [1 + \left(\frac{550}{256}\right)^2] = 1.2 \quad \text{kN/m}^2$$

$$\mu_i = 0.8, \text{ për } 0^\circ \leq \alpha \leq 30^\circ$$




Fig.10.1

$$s = \mu_i \cdot C_e \cdot C_t \cdot S_k = 0.8 \cdot 1.0 \cdot 1.0 \cdot 1.2 = 0.96 \text{ kN/m}^2$$

5.5 Ngarkesa nga Era

Zona $V_{reff,0}$




Fig.7.0 Shpejtësia e erës sipas zonave

Për regionin tone përvetësojmë në mes zones I dhe II
Lartësia mbidetare 550 m?

$$v = 26.5 \text{ m/s (95.4 km/h)}$$

$$V_{\text{reff}} = C_{\text{DIR}} C_{\text{TEM}} C_{\text{ALT}} V_{\text{reff},0} = 1.0 * 1.0 * 1.055 * 26.50 = 27.96 \text{ m/s}$$

$V_{\text{reff},0}$ - Vlera themelore e shpejtesisë referente të erës,
 C_{DIR}- faktori i drejtimit C_{DIR}=1.0
 C_{TEM}- faktori i përkohshëm C_{TEM}=1.0
 C_{ALT}- faktori i lartësisë mbidetare
 $C_{\text{ALT}} = 1 + 0.0001 * a_s = 1 + 0.0001 * 550 = 1.055$




Fig.8.0. Skemat e shpërndarjes së presionit të brendshëm dhe të jashtëm

a) Drejtimi i erës x:

Veprimi i erës në 22 m mbi nivelin e tokës:

Koeficienti i vrazhdësisë

$$C_r(Z) = k_r * \ln\left(\frac{Z}{z_0}\right) \quad \text{për } z_{\min} \leq z \leq 200 \text{ m}$$

$$C_r(Z) = c_r * (z_{\min}) \quad \text{për } z < z_{\min}$$

ku janë:

k_r – faktor i terrenit
 z_0 -gjatësia e kodrës (brigjeve)

z_{\min} -lartësia minimale

Tabela 5.0 Tabela për përcaktimin e koeficientit. K_r , z_0 , Z_{min} :

| Kategoria e terrenit | Përshkrimi | k_r | z_0 [m] | Z_{min} [m] |
|----------------------|--|-------|-----------|---------------|
| 0 | Deti apo zona e detit e hapur për në det | 0.156 | 0.03 | 1 |
| I | Teren i hapur jo i rrafshet me gjatësi se paku 5 km ne drejtim te erës dhe teren i rrafshet pa pengesa | 0.17 | 0.01 | 1 |
| II | Teren me pengesa te kufizuara,konstruksione te vogla pengese,shtepi ose drunjë (lisa,pemë etj) | 0.19 | 0.05 | 2 |
| III | Lagje periferike,zona industrial dhe pyje të përhershme | 0.215 | 0.3 | 5 |
| IV | Zona urbane në të cilat së paku 15% të sipërfaqes është e mbuluar me ndërtesa,lartësia mesatare e të cilave është mbi 15 m | 0.234 | 1.0 | 10 |

Zona II

$z_0 = 0.05$ m

$k_r = 0.19$

$Z_{min} = 2$ m




Fig.9.0 Skema e ngarkesës në lidhje me lartësinë dhe gjerësinë e sipërfaqes në të cilën vepron




Fig.10.0 Zonat e ngarkesave të muret vertikale të objekteve me bazë drejtkëndëshe

Tabela 6.0. Koeficientët e presionit të jashtëm për mure vertikale drejtkëndore

| Zone | A | | B | | C | | D | | E | |
|-------------|-------------|------------|-------------|------------|-------------|------------|-------------|------------|-------------|------------|
| | $C_{pe,10}$ | $C_{pe,1}$ | $C_{pe,10}$ | $C_{pe,1}$ | $C_{pe,10}$ | $C_{pe,1}$ | $C_{pe,10}$ | $C_{pe,1}$ | $C_{pe,10}$ | $C_{pe,1}$ |
| 5 | -1,2 | -1,4 | -0,8 | -1,1 | -0,5 | | +0,8 | +1,0 | -0,7 | |
| 1 | -1,2 | -1,4 | -0,8 | -1,1 | -0,5 | | +0,8 | +1,0 | -0,5 | |
| $\leq 0,25$ | -1,2 | -1,4 | -0,8 | -1,1 | -0,5 | | +0,7 | +1,0 | -0,3 | |

Veprimi i erës në kulm




Fig.11.0 Zonat e ngarkesave në kulm të objekteve me bazë drejtkëndëshe

Intenziteti i turbulencës caktohet sipas shprehjes:

$$I_v(z) = \frac{1}{C_o(z) * \ln(z/z_o)} = \frac{1}{C_o(z) * \ln(z/z_o)}$$




Fig.12.0 Raportet gjerësi-lartësi

$$C_r(Z) = k_r * \ln\left(\frac{Z}{Z_0}\right) = 0.19 * \ln\left(\frac{22}{0.05}\right) = 1.156$$

$$v_m(z) = c_r(z) * c_o(z) * v_b$$

$c_r(z)$ =faktori i vrazhdësisë

$c_{ro}(z)$ =faktori i orografise (zakonisht merret 1.0)

$$v_m(z) = 1.156 * 1.0 * 27.96 = 32.32 \text{ m/s}$$

$$I_v(z) = \frac{1}{c_o(z) * \ln(z/z_0)} = \frac{1}{1 * \ln\left(\frac{22}{0.05}\right)} = 0.164$$

$$q_b = \rho/2 \cdot v_b^2$$

$\rho=1.25 \text{ kg/m}^3$ dendësia e ajrit

Shpejtësia maksimale e erës $q_p(z)$:

$$q_p(z) = [1 + 7 * I_v(z)] * \frac{\rho_{2r}}{2} * v_m^2(z) = c_e(z) * v_b(z)$$

$$q_p(z) = (1 + 7 * 0.164) * \frac{1.25}{2} * 32.32^2 = 1402.35 \frac{N}{m^2} = 1.402 \text{ kN/m}^2$$

Veprimi në objekt:

Tabela 7.0

| Zona | $q_p(z)$ | Ce | we [kN/m ²] | Ci | wi [kN/m ²] |
|------|----------|------|-------------------------|------|-------------------------|
| A | 1.402 | -1.2 | -1.6824 | 0.75 | 1.261 |
| B | 1.402 | -0.8 | -1.12 | 0.75 | 0.840 |
| C | 1.402 | -0.5 | -0.701 | 0.75 | 0.525 |
| D | 1.402 | 0.77 | 1.0974 | 0.75 | 0.809 |
| E | 1.402 | -0.3 | -0.4206 | 0.75 | 0.3154 |

Veprimi i erës në kulm
Drejtimi i erës $\theta=0^\circ$ dhe $\theta=180^\circ$




Fig.13.0 Zonat me intenzitet të erës në objekt

Tabela 8.0. Koeficientët e presionit të jashtëm për kulme të rrafshëta

| Forma e strehës | | Zonat | | | |
|-----------------|------------|--------|--------|--------|--------|
| | | F | G | H | I |
| | | cpe,10 | cpe,10 | cpe,10 | cpe,10 |
| Me parapet | hp/h=0.025 | -1.6 | -1.1 | -0.7 | ±0.2 |
| | hp/h=0.045 | -1.523 | -0.952 | -0.7 | ±0.2 |
| | hp/h=0.05 | -1.4 | -0.8 | -0.7 | ±0.2 |

Me anë të interpolimit gjejm koeficientet Cpe

Tabela 9.0

| Zona | qp(z) | Cpe | we± [kN/m2] |
|------|-------|--------|----------------|
| F | 1.402 | -1.523 | -2.135 |
| G | 1.402 | -0.952 | -1.334 |
| H | 1.402 | -0.7 | -0.9814 |
| I | 1.402 | -0.2 | -0.2804 |

Ngarkesat e erës-zonat në ramën të rthor




Fig.14.0 Ngarkesa e erës

6.0 LLOGARITJA E STRUKTURËS

Llogaria statike është punuar me ndihmën e programit “Tower 7.0”, e bazuar në metodën e elementeve të fundme, ku konstruksioni është shqyrtuar si konstruksion hapësinor. Në modelin matematik të strukturës janë futur të gjitha përmasat e elementeve përbërëse të strukturës si ato horizontale dhe vertikale, ngarkesat me vlerë të intensiteteve përkatëse dhe është bërë llogaritja e strukturës ku janë fituar edhe rezultatet dalëse në bazë të cilave janë bërë edhe armimi i prerjeve tërthore të elementeve të strukturës.

Efektet inerciale të veprimit sizmik janë bërë duke marrë parasysh pranimin e masave që u përgjigjen të gjitha ngarkesave peshë që caktohen sipas shprehjes (3.16). dhe tabelës A.1.1 të EN 1990-2002. Numri i formave të lëkundjeve është përvetësuar deri në atë masë që të plotësohet kushti që participimi i masës në format e lëkundjeve të jetë ma e madhe se sa 90%.

Rëndësia e objekti është përvetësuar e kategorisë së III-të.

Supozohet klasa “M” e sjelljes: DCM (medium ductility).

Faktori i sjelljes është përvetësuar në funksion të tipit të strukturës në fjalë sipas shprehjes (5.1 Ec-8) dhe tabelës për vlera bazë të faktorit të sjelljes për sisteme të rregullta në lartësi (Tab.5.1 Ec-8).

Kategoria e truallit: B

Kategoria e rëndësisë: III-të ($\gamma=1.2$)

Nxitimi i truallit: $ag/g=0.22$

Faktori i sjelljes: q

$$q = q_0 \cdot k_w$$

q_0 - vlera bazë e faktorit të sjelljes që varet nga tipi i sistemit strukturor dhe rregullsia në lartësi (pika 2)

k_w - faktor që merr parasysh mënyren kryesore zotëruese të shkatrrimit në sistemin strukturor me mure shih piken 11.

Për ndërtesat e rregullta në lartësi sipas pikës 4.2.3.2 për tipe të ndryshme strukturore vlera bazë e faktorit të sjelljes q_0 jepet në tabelen 11-1.1 EC8

Tab.8.0


| TIPI STRUKTUROR | DCM | DCH |
|--|---|---------------------------|
| Sistem rame, sistem dual, sistem me mure të qiftezuar | $3.0 \alpha_u / \alpha_1$ | $4.5 \alpha_u / \alpha_1$ |
| Sistem me mure | 3.0 | $4.0 \alpha_u / \alpha_1$ |
| Sistem me fleksibilitet përdredhes (i perkulshëm nga përdredhja) | 2.0 | 3.0 |
| Sistem i tipit lavjerrës i përmbysur | 1.5 | 2.0 |

